



Pranuar / Dorezuar Punileno/Prodato Received/Delivered	03.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojta Pufteg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHICK	5794/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.879/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.879/2021 të datës 22.10.2021 të parashtruar nga

dhe të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati me adresë Rruga "Idriz Gjilani", Hyrja 1, Nr.11 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.879/2021 e datës 22.10.2021 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të gjithë të punësuar në Sekretariatën e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar avokatit me datë 15.09.2021 nëpërmjet e-mail-it kanë parashtruar kërkesë në Sekretariatën e Këshillit të Sigurisë së Kosovës kërkesën për njohjen e kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës (shujtës) për periudhën nga data 01.01.2015 gjer më datën 31.12.2018 periudhë sa ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e datës 18.03.2014.

Ankuesit pasi që nuk marrin përgjigje lidhur me kërkesën e tyre të datës 15.09.2021 për kompensim material me datë 22.10.2021 nëpërmjet e-mai-li zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës parashtrorj në ankesën me numër të protokollit 5118/2021 me pretendim ankimor që të detyrohet Këshilli i Sigurisë së Kosovës që të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesve për të drejtën e kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë ditës (shujtës) për periudhën kohore duke filluar nga data 01.01.2015 gjer më 31.12.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Këshillin e Sigurisë së Kosovës. Me datë 25.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 22.10.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për kompensim e datës 15.09.2021 e parashtruar pranë organit të punësimit; Autorizimi i datës 03.09.2021 për Avokatin nga Letër njoftimi kopje për Vërtetimi i datës 25.08.2021; Autorizimi i datës 03.09.2021 për Avokatin nga Kopja e letër njoftimit për Vërtetimi i datës 23.08.2021; Autorizimi i datës 03.09.2021 për Avokatin nga Kopja e letër njoftimit për Vërtetimi i datës 23.08.2021; Autorizimi i datës 03.09.2021 për Avokatin nga Kopja e letër njoftimit për Vërtetimi i datës 23.08.2021; Akt emërimi i datës 16.11.2017 i Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit i datës 09.06.2014 i datës Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i 09.06.2014 për Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 02.09.2019 i si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesit të punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në pozita të nëpunësve civilë, përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 15.09.2021 kanë parashtruar kërkesë në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, kërkesën për njohjen e të drejtës për kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë punës (shujtës) për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2018.

Ankuesit të pakënaqur me heshtjen për shqyrtim të kërkesës së datës 15.09.2021 të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës ndaj kërkesës se tyre për kompensim material, në ankesën e datës 22.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes përfaqësuesit të tyre, pretendojnë që Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nuk ka bërë kompensim e shpenzimeve për shujtën ushqim ditore prej dy (2) Euro gjatë punës, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.


Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës nga data 01.01.2015 gjer më 31.12.2018 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.879/2021

Valentina Kaçandolli Bektashi

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat
- Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Menaxheres së Personelit në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

